



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
KOMISIONI I POSAÇËM PARLAMENTAR

VENDIM
Nr. 15, Datë 28.10.2024

"Për miratimin e hapave për organizimin e procesit të konsultimit publik"

Bazuar në nenet 24 dhe 32 - 41 të Regullores së Kuvendit dhe në vendimin Nr. 50/2024, datë 30.05.2024 të Kuvendit të Shqipërisë "Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm për Thellimin e Reformave për Mirëqeverisjen, Sundimin e ligjit dhe Antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Evropian", me propozim të Kryetarit, Komisioni i Posaçëm Parlamentar

VENDOSI:

1. Të miratojë procesverbalin e zbardhur të mbledhjes paraardhëse, të zhvilluar më datë 26.07.2024.
2. Të miratojë masat e propozuara nga Grupet e Ekspertëve të Nivelit të Lartë (GENL) për realizimin e procesit të konsultimit publik, lidhur me draft - Dokumentin Analitik, përmes:
 - Organizimit të tryezave tematike publike, sipas Kalendarit bashkëlidhur këtij Vendimi (*Aneksi 1*);
 - Organizimit të forumeve të dialogut qytetar, me fokus trajtimin e çështjeve me interes dhe ndjeshmëri të lartë për qytetarët;
 - Konsultimit me grupet e interesit, përfshi institucionet shtetërore dhe agjensitë ekzekutive ligjzbatuese;
 - Konsultimit të draftit të Dokumentit Analitik me ekspertë dhe konsulentë ndërkombëtarë, për marrjen e vlerësimeve dhe komenteve të tyre në lidhje me përputhshmërinë e tij me standardet ndërkombëtare, si dhe për të reflektuar përvojat më të mira ndërkombëtare në këto fusha.

Në përfundim të këtyre hapave, vlerësimet, gjetjet dhe propozimet e mbledhura do t'u përcillen Grupeve të Ekspertëve për t'u integruar në Dokumentin Analitik. Në përmbyllje të këtij procesi, drafti përfundimtar i Dokumentit Analitik do t'i paraqitet Komisionit të Posaçëm Parlamentar për shqyrtim dhe miratim.

3. Ngarkohen Grupet e Ekspertëve të Nivelit të Lartë (GENL) dhe të Sekretariatit Teknik (ST) që të dorëzojnë përmbledhjet ekzekutive të Dokumentit Analitik, për të 3 shtyllat, brenda datës 31 tetor 2024, me qëllim publikimin e tyre në faqën web të Komisionit.
4. Ngarkohen Sekretariati Teknik dhe Njësia Mbështetëse për ndjekjen dhe organizimin e procesit si më sipër.
5. Kostot e nevojshme për zhvillimin e procesit të konsultimit, në zbatim të këtij Vendimi, do të mbulohen sipas rregullave nga Kuvendi i Shqipërisë.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

FATMIR XHAFAJ



Miratuar më 28.10.2024